



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.146/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti, dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.01.2025, merr këtë :

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.146/2025 datë 23.01.2025.
- II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3000.00 (Tremijë) Euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendohet se më datë 23 Janar 2025, aktivistet e Partisë Demokratike të Kosovës, kanë identifikuar banerin/posterin e kandidatit për deputet Halil Thaçi, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të vendosur në fshatin Milloshevë, konkretisht në magjistralen Prishtinë- Mitrovicë.

Më tutje në ankesë pretendohet se vendosja e posterit nga ana e kandidatit për deputet Halil Thaçi, në hapësirat publike është bere pa lejen dhe pëlqimin e pronarit.

Me këtë veprim kandidati dhe Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP.

Si provë për pretendimet në ankesë, parashtruesi ka bashkangjitur fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Më datë 24.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre.

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), theksohet se sa i përket rastit në fjalë, LVV ka ofruar përgjigje në ankesë me numër Anr.141/2025, me datë 24 janar 2025, për çështjen dhe posterin e njëjtë.

Me tutje në përgjigje në ankesë theksohet se baneri/posteri i kandidatit nga radhët e LVV është vendosur me pëlqimin paraprak të dhënë nga pronari i pronës, që është në përputhje me nenin 7 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Një gjë e tillë mundë të konfirmohet edhe nga pronari i pronës.

Në përgjigje në ankesë si provë ka bashkëngjitur fotografi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LVV, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik PDK, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Në rastin konkret pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me kandidatin në fjalë janë të bazuara për shkak se i njëjti e ka vendosur posterin në Fshatin Milloshevë, në magjistralen Prishtinë- Mitrovicë, pa Pëlqimin dhe lejen e pronarit ose Pëlqimin nga Organi Kompetent, dhe se veprimet e tilla paneli i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Paneli me rastin e vendosjes së vendimit për lartësinë e gjobës ka vlerësuar rrethanë lehtësuese faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë përpjekje të arsyeshme për ta evituar shkeljen - heqjen e posterit nga rruga publike, që ishte vendosur nga kandidati për deputet Halil Thaqi nga radhët e Subjektit Politik LVV.

Pretendimi subjektit politik lëvizja Vetëvendosje në përgjigjen në ankesë se baneri i vendosur nga radhët e LVV është vendosur në magjistralen Prishtinë – Mitrovicë, me pëlqimin e

pronarit të pronës z.Berat Stublla, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që në përgjigjen në ankesë, nuk është bashkangjitur asnjë pëlqim nga Berat Stublla, dhe nuk është bashkangjitur asnjë leje përkatëse nga organi kompetent për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.146/2025 datë 25.01.2025

Kryesuese e Panelit,
Bujar Muzaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.